



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:056907

Datë: 03.10.2024

Numri i dokumentit: 06248646

K.Dh.Sh.II.nr.1209/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS–Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Raiffesien Bank Kosovë, (RBKO), me seli ne Prishtinë, kundër debitorëve: 1. “Euro Testing” Sh.P.K. me përfaqësues F.D., me adresë në ..., Kaçanik, 2. F.D. me adresë në ..., Kaçanik dhe 3. B.S. me adresë në ..., Kaçanik, me objekt përmbartimi pagesën e kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2001/2022 të datës 17.08.2023, me datën 03.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorëve: 1. “Euro Testing” Sh.P.K. me përfaqësues F.D., me adresë në ..., Kaçanik, 2. F.D. me adresë në ..., Kaçanik dhe 3. B.S. me adresë në ..., Kaçanik, ANULOHET aktvendimi i Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë KPPP.nr.2001/2022 të datës 17.08.2023 dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

1 (5)

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2001/2022 të datës 17.08.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve të përmbarimit 1. “Euro Testing” Sh.P.K., 2. F.D. dhe 3. B.S., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.60/2022 të datës 14.02.202, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi, në pikën II e ka lënë në fuqi urdhërin e përmbarimit P.nr.60/2022 të datës 14.02.202, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitorët për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovet ankesa e debitorit në tersi si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i datës 17.08.2023 si dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e debitorit dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2001/2022 të datës 17.08.2023, të mbetet në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përmbarimore e përmbaruesit privat Përparim Xhelili në Gjilan, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbarimor me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi Pengun e datës 27.12.2019 e regjistruar sipas Certifikatës për regjistrimin e pengut R-20191231-255 për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja për Kredinë 200724193 si dhe Marrëveshjen mbi Pengun e datës 08.01.2020

regjistruar sipas Certifikatës mbi regjistrimin e pengut 20220210-46, për sigurimin e kërkesa nga Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës e datës 08.01.2020, mbi borxhin total prej 23,270.99 euro, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër propozimit për përmbarimin, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij prapësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përmbaruesit privat për arsye se nuk qëndroj asnjë nga arsyet që parashihen me LPP-në. Me tej të njëjtit kanë shtuar se në rastin konkret kreditori ka paraqitur dokumente të rrejshme dhe të pa vërteta pasi që debitorët nuk kanë obligime ndaj kreditorit.

Kreditorët brenda afat ligjore kanë paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar pretendimet e debitorëve, dhe duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorëve si i pa bazuar.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2001/2022 të datës 17.08.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve të përmbarimit 1. “Euro Testing” Sh.P.K., 2. F.D. dhe 3. B.S., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.60/2022 të datës 14.02.202, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi, në pikën II e ka lënë në fuqi urdhërin përmbarimit P.nr.60/2022 të datës 14.02.202, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkalles e Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale po ashtu aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka qenë e obliguar që të vlerësoj nëse janë përmbushur prezumimet lidhur me përmbajtjen e dokumenteve përmbartimore që duhet ti bashkëngjiten propozimit për përmbartim, kështu gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlersuar se në rastin konkret dokumentet në bazë të cilave është caktuar përmbartimi a i plotësojnë kushtet e parapara me dispozita ligjore për të qenë dokumente të përmbartueshme, pasi që gjykata e shkallës së parë ka cek vetëm Certifikatën për rregjistrimin e pengut me R-20191231-255 dhe R-20220210-46 se janë në origjinal por nuk ka vlersuar se dokumente tjera përmbartues a janë në origjinale ose kopje të vërtetuara, siç parashihet me dispozitat ligjore. Neni 36 par.1 të LPP përcakton se *“Se bashku me propozimin për përmbartim, organi përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*. Ngase edhe sipas neni 38 par.1 të LPP-së, parashihet që propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë: *“kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar....”* ndërsa me paragrafin 2 parashihet se: *“Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili nen në paragrafin 1 përcakton, se: “Kur një parashitës nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashitësin. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashitësës”*. Andaj në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar këtë fakt me rastin e vendosjes, për çka gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se aktvendimi i shkallës së parë është i paqëndrueshëm dhe si i tillë duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rishqyrtim.

Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve konform të gjeturave nga gjykata e shkallës së dytë, ashtu që të konfirmoj se dokumentet mbi bazën e të cilave është caktuar përmbartimi a i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të përmbartueshme, të analizoj pretendimet të palëve në procedurë, të konstatoj saktë gjendjen e fakteve me prova konkrete, e më pastaj duke vlersuar edhe shkaqet ligjore nga neni 71 të LPP-së, të vendos sipas dispozitave ligjore.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195, 208 dhe 209 par. 1 pika (d) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1209/23, me datë 03.10.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri